



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

(Vizitë informuese pranë institucionit të Komisionerit për Shërbimit Civil)

PROCESVERBAL

Tiranë, më 2 prill 2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Informacion në lidhje me realizimet dhe rolin e Komisionerit për Shërbimin Civil, si institucion i pavarur dhe autoriteti përgjegjës që mbikëqyr dhe monitoron zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
2. Informacion në lidhje me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë për rikthimin në detyrë të punonjësve. Si ka rezultuar gjendja në 112 institucione dhe çfarë masash ka ndërmarrë Komisioneri. Duke sjellë në vëmendje që kjo problematikë ka efekt financiar negativ në buxhetin e institucioneve, rrjedhimisht në buxhetin e shtetit *(për një pozicion punë paguhen 2 ose 3 punonjës)*.
3. Cilat janë dispozitat ligjore që shfaqin paqartësi apo mangësi në interpretimin dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore?! A ka depozituar Komisioneri në organet e Kuvendit sugjerime për ndryshime/përmirësime ligjore në funksion të zgjidhjes së problematikës?
4. Kontrolli i Lartë i Shtetit, në veprimtarinë e tij audituese, gjithashtu vlerëson zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” në organet e administratës qendrore dhe vendore. Në kuadër të marrëveshjes ndërmjet KMSHC dhe KLSH, a keni rezultate konkrete?!
5. Në raportimet periodike të Komisionerit të depozituara në Kuvend, evidentohet vazhdimisht problematikë në zbatimin e ligjit në organet e administratës vendore. A ka menduar

KMSHC-ja në koordinim me DAP-in dhe Shkollën e Administratës Publike, hartimin e një manuali udhëzues/sqarues për njësitë që administrojnë shërbimin civil në institucionet publike?!

6. Statusi i rekomandimeve të progresraportit (2018) të Komisionit European për Komisionerin e Shërbimit Civil, në lidhje me rritjen dhe fuqizimin e kapaciteteve institucionale.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Edmond Leka dhe Elena Xhina

Mungojnë:

Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Damian Gjiknuri dhe Tom Doshi

HAPET MBLEDHJA

Pranvera Strakosha - ...në zyrat dhe ambientet e Komisionerit. Ju presim në ambiente të reja, të bëra pas një rikonstruksioni me fondet e buxhetit të shtetit. Jemi vendosur shumë mirë në ambiente, dhe sa për punën, sigurisht, jo se nuk e bënim mirë në ato të tjerat, por tani gjithçka është më e këndshme.

Komisioneri ka hyrë në vitin e pestë të funksionimit të tij si institucion. Ashtu siç e dini, kemi raportuar çdo vit para Kuvendit, qoftë me raporte vjetore, ashtu edhe me raportet e inspektimeve të përmuajshme që nxjerrim, të cilat ia dërgojmë Komisionit të Ligjeve, ndërsa çdo tre muaj sjellim edhe një përmbledhje të veprimtarisë.

Nuk e di nëse duhet të pasqyroj një gjë shkurt për tërë vitin, apo në lidhje me problematikat. Nuk e di si mendoni ta zhvillojmë bisedën.

Ulsi Manja – Shumë faleminderit, për pritjen!

Për ne kjo është një ditë normale pune si Komision i Ligjeve, por edhe i Nënkomisionit për Administratën Publike.

Vizita jonë e sotme në këtë institucion është në kuadrin e ushtrimit të kontrollit parlamentar. Të njëjtën vizitë e kemi bërë edhe te Komisioneri i Mbrojtjes së të Dhënave Personale. Sot jemi në institucionin që drejtoni ju. Do të vazhdojmë me të gjitha institucionet që janë në fushën e përgjegjësisë së Komisionit të Ligjeve. Janë diku rreth 18 institucione, të cilat raportojnë drejtpërsëdrejti në komisionin tonë. Në fakt, ne i kemi treguesit e punës për vitin 2018, të institucionit që ju drejtoni. Ju shumë shpejt do të vini të raportoni edhe në Komisionin e Ligjeve. Për ne do të ishte me interes një ditë e zakonshme pune në institucion. Pra, si e nis ditën e punës Komisioneri për Mbrojtjen e Shërbimit Civil dhe cila është një ditë e zakonshme pune e stafit që ju drejtoni. Do të ishte me interes për ne, që të dimë vështirësitë që hasen, dhe nëse është e nevojshme, të dimë nëse këto vështirësi vijnë për shkak të ligjit apo për shkak të bashkëpunimit me institucionet, se janë rreth 112 institucione, që u nënshtrohen ligjit “Për nëpunësin civil”, sipas asaj që edhe ju keni raportuar në Kuvend.

Pranvera Strakosha – Ato janë vetëm, pa institucionet e varësisë.

Ulsi Manja – Pa institucionet e varësisë. Ne dum të dimë pastaj, vështirësitë dhe problematikat që hasen. Të çfarë natyre janë vështirësitë që ju keni hasur gjatë këtyre pesë vjetëve të ushtrimit të veprimtarisë tuaj. Pra, një ditë normale pune.

Pranvera Strakosha – Qartë! Atëherë, në bazë të planit vjetor, të gjitha grupet e inspektorëve apo drejtoritë e kanë filluar aktivitetin. Me të hyrë janari, ato e kanë ditur se çfarë do të bëjnë, në fakt sot një pjesë i kam me shërbim, duke filluar që nga drejtoresha e Përgjithshme. E kam vlerësuar të nevojshme që të dërgoj edhe drejtorët nëpër inspektime, pasi pushteti vendor ka pasur shumë problematika. Vitin e kaluar i përfunduar të gjitha bashkitë, njësitë e qeverisjes vendore, dhe konstatuam se ato e njihnin ligjin “Për nëpunësin civil” shumë pak ose aspak. Jo se nuk donin të zbatonin ligjin. Sigurisht, ka edhe momente subjektive, pasi duke qenë se kryetarët e bashkisë e mendojnë veten se janë shumë të fuqishëm, kjo edhe për shkak të mënyrës se si vijnë në atë detyrë, pra që zgjidhen nga populli. Kështu, shumë herë ata nuk respektojnë konsultimet apo këshillat e njësisë së burimeve njerëzore. Megjithatë, duke qenë se ne kemi vënë në dukje çdo lloj problematike, kemi gjetur konsensusin dhe po shikojmë se njësitë e qeverisjes vendore, përfshirë edhe kryetarët, po zbatojnë vendimet e Komisionerit. Shifrat janë në raport, kështu që nuk po zgjatëm me to.

Çfarë konstatuam në këto vite? Konstatuam se ka vështirësi, pasi ligji është i ri, ka shumë VKM, që zbërthejnë dispozita dhe institute të caktuara të ligjit, ndaj ka pasur nevojë të përgatiteshin dhe materialet-tip, që do të thotë: modularë, formularë, mënyra se si procedohet, qoftë për rekrutimet apo për procedimin disiplinor, për vlerësimin e punës, për përshkrimet e punës.

Në fakt, kemi bërë edhe katër seminare, në bashkëpunim me Këshillin e Europës, me njësitë e qeverisjes vendore, me njësitë përgjegjëse, që ne i kemi kryesisht me struktura. Vjet konstatuam e strukturat ishin shumë kaotike, dhe ato kishin nxjerrë qëllimisht nga shërbimi civil drejtori të tëra. Pra, shkonim në bashki dhe gjenim vetëm 15 vetë shërbim civil. Kishin gjetur një artific me të ashtuquajturën agjenci e të tjera e të tjera.

Si e nis punën komisioneri? Me të ardhur në punë ka mbi tavolinë gjithë materialet, që inspektorët dhe drejtoritë kanë përgatitur një ditë më parë, pasi të gjitha materialet kalojnë në disa etapa. Nxirret urdhri i inspektimit, ngrihet grupi i inspektimit, drejtori vendos problematikat, i ndjek inspektorët, kur ata shkojnë në subjekt. Kryesisht, ne u dërgojmë institucioneve një shkresë paraprake, u themi çfarë kërkojmë, u caktojmë ditën se kur do të shkojnë atje punonjësit tanë, në

mënyrë që kur të shkojnë, të mos zgjaten shumë me marrjen dhe verifikimin e dokumentacioneve. Vijnë inspektorët, bëhet një relacion, miratohet nga drejtori përkatës, miratohet nga drejtori i Përgjithshëm, vjen mbi tavolinën e Komisionerit, ku gjej çdo mëngjes të gjitha llojet e relacioneve që nxjerrim.

E konstatoj nëse është në rregull ose jo. Nëse nuk është në rregull, bëj vërejtjet e mia dhe i kthej mbrapsht për verifikime plotësuese, në rastin kur konstatoj se nuk janë bërë të sakta. Kur është gjithçka në rregull, e miratoj. Më pas kalojmë në fazën e dytë, nxjerrjen e vendimit, që bën të njëjtën linjë: drejtori, drejtori i Përgjithshëm, drejtori juridik, e më pas vjen te Komisioneri. Kështu që, materiale ka pothuajse përditë, problematika ka përditë. Kjo ishte në lidhje me inspektimet e përgjithshme.

Për sa u përket ankesave, ato vijnë në rrugë të ndryshme: qoftë me postë, qoftë nëpërmjet e-mailit. Në momentin e parë, punonjësja e marrëdhënieve me publikun konstaton se ka ardhur një ankesë, ankesa vjen direkt te Komisioneri. Nga ky moment çështja vihet në lëvizje dhe fillojnë verifikimet. Edhe verifikimet e ankesave të tjera mundohem t'i mbyll brenda 30 ditëve, sepse nëse kalon koha humbet edhe aktualiteti i ankesës. Mund të jetë ankuar për vlerësimin e punës, mund të jetë ankuar për një fillim procedimi disiplinor, për një transferim të përkohshëm, që e ka konstatuar të parregullt e të tjera. Përsëri inspektori njofton institucionet, shkon në subjekt dhe merr problemikat.

Çfarë vështirësish kemi konstatuar? Në fakt, fillimisht, ditët e para institucionet refuzonin të jepnin informacion, sepse ishin mësuar të mbanin njëfarë fshehtësie apo mbylljeje, për të mos nxjerrë ato çfarë kishin bërë. me këmbënguljen e Komisionerit, kam përshtypjen edhe me ndërgjegjësimin, sepse ligji parashikon se Komisioneri ka të drejtë të vërë edhe gjobë, sot nuk kemi asnjë lloj problematike në lidhje me marrjen e dokumentacionit dhe shumë herë mund të them se ne na përgjigjen më shpejt institucionet e tjera që i ka në varësi. Sapo komisioneri dërgon një shkresë për informacion, apo dokumentacion ato vijnë menjëherë.

Çfarë problematikë kemi konstatuar në zbatim edhe të një pike të rezolutës së Kuvendit. Vitin e kaluar Kuvendi na vendosi një detyrë, të cilën e morëm me kënaqësi përsipër të verifikonim vendimet gjyqësore të formës së prerë, pasi është një problematikë që është mbartur në vite: pse nuk ishin ekzekutuar? Në fazën e parë kemi grumbulluar të gjitha vendimet gjyqësore në 112 institucione, që është shifra të cilën e kemi në raport, pa përfshirë institucionet e varësisë, pasi ishte një punë shumë voluminoze. Kemi mbledhur vendime gjyqësore. Konstatuam që

institucionet kishin vështirësi të jepnin informacion. Nuk kuptonin se çfarë u ishte kërkuar dhe ne dërgonim punonjësit tanë për të marrë një e nga një vendimet gjyqësore. Kemi konstatuar se kanë mbetur pa u ekzekutuar 311 vendime, është si shifër edhe në raport. Ne do të ecim në fazën e dytë për të vazhduar me ekzekutimin konkret.

Patëm një rast, si rast pilot në Ministrinë e Bujqësisë, ata refuzonin të zbatonin vendimin duke thënë: “Nuk kemi pozicion pune”. Kemi marrë strukturën, organikën dhe kemi konstatuar se mbanin në punë një punonjës, i cili duhet të kishte dalë para 8 muajve në pension, duke thënë: “Ia bëjmë si nder”. Kemi kërkuar të zbatojnë ligjin “Për lirim nga shërbimi civil”, sepse është kërkesë e ligjit pas mbushjes së moshës dhe pozicionet e punës ishin të lira, për t’u ekzekutuar më pas vendimi gjyqësor.

Kemi konstatuar, unë e kam ngritur edhe vitin e kaluar edhe këtë vit në raport, se një pengesë shumë e madhe është neni 66/1 që është miratuar me ndryshimet që iu bënë ligjit në fund të vitit 2014. Ky nen është një dispozitë që për mua duhet të jetë tranzitore: “Për zbatimin, ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë”. Vendimet e formës së prerë zbatohen dhe ekzekutohen sipas kërkesave të ligjit. Kemi Kodin e Procedurës Civile, normalisht nuk kishte pse të ishte një dispozitë e tillë në ligjin “Për nëpunësin civil”, megjithatë ajo është vendosur. Pengesë është fakti se dispozita kërkon që nëse pozicioni nuk ekziston më, pasi strukturat janë dinamike dhe ndryshojnë, punonjësi me pëlqimin e tij të emërohet në një pozicion tjetër të shërbimit civil ekuivalent, por që i plotëson kriteret e përgjithshme dhe të posaçme. Fjalët “me pëlqimin e tij” u japin të drejtë punonjësve të thonë: “Jo, nuk jam dakord të shkoj atje!” dhe nuk e japin pëlqimin. Kishim një rast, të një punonjëse që e kishte marrë mbi 100 milionë lekë të vjetër pagën, sepse nuk pranonte pozicionet e punës që i kishin ofruar në një ministri, po në shërbimin civil. Ndërkohë ishte punësuar në një institucion jashtë shërbimit civil.

Këto janë dy momente që ne kemi ngritur. E para, kemi mbajtur një qëndrim që nëse punonjësi ka vendim gjyqësor të formës së prerë dhe neni 66/1 shprehet se i paguhet paga deri sa të sistemohet, por ndërkohë është i punësuar në një pozicion tjetër jashtë shërbimit civil, ai nuk mund ta marrë pagën, sepse nuk mund të paguhet me dy paga. Ligji kur i ruan të drejtën për të marrë pagën, ia ruan për faktin se duhet të mos ulet standardi, niveli, por jo që të përfitojë dy paga nga buxheti i shtetit, qoftë edhe nga privati. Ne në këtë rast kemi mbajtur qëndrim, se duhet të merret vetëm kompensimi i pagës, pra niveli i pagës që ka pasur, me diferencën. Kjo duhet të zgjidhet nëpërmjet Ministrisë së Financës dhe Ministrisë së Drejtësisë. Unë e ngrita edhe në një

takim që kisha me ministren për Marrëdhëniet me Parlamentin, zonjën Spiropali, ku i shpreha se duhet të shikohet një mundësi, të dilet me një VKM dhe me një udhëzim, në mënyrë që institucionet të fillojnë t'i zbatojnë.

Një problematikë tjetër, për mua është se duhet të ndryshojë ligji “Për përmbarimin shtetëror” dhe marrëdhëniet e punës me palë shtetin t'i ndjekin përmbaruesit shtetërorë, sepse kam parë që përmbaruesit privatë për shkak se ka pak edhe interesin e tij, duke qenë se merr përqindjet mbi tarifën, ne edhe pse i kemi njoftuar dhe kemi mbajtur qëndrim pasi nuk mund t'i merren institucionit dy paga, kur merr një pagë tjetër, ata kanë vazhduar me të njëjtin qëndrim. Unë mendoj se zbatimet e këtyre vendimeve gjyqësore duhet t'i kalojnë përmbaruesit shtetëror, përmbarimit se përndryshe për çfarë e kemi atë si institucion.

Këto janë dy momentet që ne kemi ndeshur në vështirësi. Çfarë kemi konstatuar? Pjesa më e madhe e vendimeve të formës së prerë, janë largime nga puna për shkak të ristrukturimit. Ligji e thotë qartë, në nenin 50, se nëse largohet për shkak të ristrukturimit dhe nuk mund të sistemohet në një nga momentet që parashikon ligji, në të njëjtin institucion, në pozicion paralel në një institucion varësie ose në atë që ka thithur kompetencat, atëherë ai do të lirohet nga shërbimi civil dhe do të marrë pagën në bazë të vjetërsisë, sa vjet punë ka, aq muaj do të marrë pagë. Kemi konstatuar se jo gjithmonë gjykatat kanë bërë një hetim të plotë dhe të thellë të rastit. Nëse vijnë ankesa te Komisioneri për largimin nga shërbimi civil për shkak të ristrukturimit ne marrim të gjitha strukturat, të mëparshmet, të tanishmet dhe përshkrimet e punës. Në fakt gjykata nuk e ka bërë këtë gjë. Kemi vendime gjyqësore ku thuhet: “Të kthehet në vendin e mëparshëm të punës!”. Ai vendi i mëparshëm i punës, nuk ekziston më. Kjo tregon për një mangësi në momentin e hetimit gjyqësor dhe të hetimit administrativ. Në këtë fazë që kemi mbyllur ne do të fillojmë seanca dëgjimore, duke filluar nga ministritë, duke analizuar çdo pozicion pune, vakanca, që kanë qoftë ministritë, qoftë institucionet e varësisë do të shikojmë përshkrimet e punës, në mënyrë që ne të informojmë, të rekomandojmë dhe të themi: “Ky punonjës i plotëson kriteret për 1,2,3 dhe 4 pozicione vakante”, pastaj do t'ia kalojmë departamentit, sepse në bashkëpunim me të do ta bëjmë të gjithë procesin, që të bëjë emërimet dhe ekzekutimet e vendimeve gjyqësore.

Kemi konstatuar se një pjesë janë ekzekutuar vullnetarisht. Është ulur numri i largimeve nga shërbimi civil, për shembull ne monitoruam të gjithë ristrukturimin e ministrive dhe pse kishte

shkurtim të ndjeshëm të numrit të pozicioneve të punës vetëm 50 vetë janë liruar nga shërbimi civil, të gjithë të tjerët janë sistemuar në institucione qoftë të varësisë ose në institucionet paralele.

Këto mendoj se janë problematikat. Nisur nga ka çdolloj njoftimi që del në shtyp, apo çdo e dhënë që del në medie ne fillojmë menjëherë verifikimet, nuk presim që të vijë ankesa pranë Komisionerit. Kemi një punonjëse që ndjek shtypin, të gjithë problematikën.

Ulsi Manja – Do të kenë pyetje edhe kolegët. Unë kam disa pyetje të shkurtra: Komisioneri është në dijeni për vendet që janë të lira në shërbimin civil? Si i keni raportet e bashkëpunimit me Departamentin e Administratës Publike? A ju vënë në dijeni apo jeni të azhurnuar në çdo kohë me vendet në shërbimin civil?

E dyta, në raportimin që do të bëni këtë vit në Komisionin e Ligjeve, unë kam kërkuar që raportit të institucionit tuaj t'i bëhet një *crosscheck* me gjetjet e departamentit, me raportin e Departamentit të Administratës Publike, por edhe me gjetjet e Kontrollit të Lartë të Shtetit në ato institucione që edhe janë audituar nga ju, nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, por edhe se çfarë ka raportuar Departamenti i Administratës Publike për të parë edhe...

Pranvera Strakosha – Se sa rakordojnë.

Ulsi Manja – ...se sa rakordoni si institucione me njëri-tjetrin. Më vjen mirë që është ulur numri i largimeve nga shërbimi civil, por dua të di se si i rakordoni vendet e lira në shërbimin civil me Departamentin, apo nuk ju informojnë fare?

Pranvera Strakosha – Ka një moment. Departamenti i Administratës Publike, pasi evidenton pozicionet e lira, del me vendim të Këshillit të Ministrave për të gjitha hapësirat dhe numrin e pozicioneve të lira në të gjitha nivelet e punësimit. Në fakt, kjo është shifra që ne marrim, sepse kjo është edhe shifra zyrtare dhe mbi bazën e kësaj të fundit Departamenti do të fillojë të bëjë...

Ulsi Manja – E merr në fillim të vitit?

Pranvera Strakosha – Po, po, vendimi i Këshillit të Ministrave del çdo janar dhe shpallet i gjithë procesi.

Ulsi Manja – Për sivjet ka dalë VKM-ja?

Pranvera Strakosha – Po.

Ulsi Manja – Sa pozicione të lira janë në shërbimin civil?

Pranvera Strakosha – Në mos gabo, 1005.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në qoftë se nuk e thashë të saktë, mund ta nxjerrim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo ishte nga sa më kujtohet mua.

Mbi këtë bazë Departamenti fillon të bëjë konkurrimet në grupe. Në fakt, realisht me Departamentin kemi marrëdhënie shumë të mira realisht. Ne kemi një grup të përhershëm inspektorësh, të cilët ndjekin të gjitha llojet e konkurrimeve, i kemi lidhur me punonjësit e Departamentit, të cilët merren me rekrutimet, dhe ne fillojmë monitorimin që në momentin që shpallen pozicionet e punës: kërkesat e para, del lista paraprake, bëhen ankimimet, del lista përfundimtare dhe pastaj fillojnë të bëhen rekrutimet. Pra, ne i dimë pozicionet e lira që në momentin kur del vendimi i Këshillit të Ministrave.

Nuk është se ka ndonjë problematikë lidhur me këtë gjë, por kemi konstatuar që institucionet jo gjithnjë i deklarojnë të gjitha pozicionet e lira të punës. Pra, nuk është problemi te Departamenti...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Por ata që i çojnë DAP-it informacion jo gjithmonë i deklarojnë vendet e lira.

Ne u kemi bërë kërkesë institucioneve dhe kemi kërkuar deri më 30 qershor se cilët janë punonjësit që dalin në pension. Kemi edhe një databazë. Këtë gjë e bëjmë në funksion edhe të zbatimit të vendimeve të formës së prerë, pra do të shikojmë pozicionet që lirohen, pozicionet që DAP-i ka shpallur të lira dhe ato që lirohen deri më 30 qershor, në mënyrë që të fillojmë dhe të sistemojmë punonjësit që janë larguar dhe kanë një vendim gjykatë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për sa i përket...

Bashkim Fino – Të them diçka?

Ju falënderoj, së pari, zonja Komisionere, që na pritët!

Në fakt, kontrolli parlamentar është shumë i rëndësishëm, ndaj ne duhet ta bëjmë shumë herët, më shpejt dhe më me cilësi bashkëbisedimin me të gjithë stafin tuaj, me ju personalisht dhe me të gjitha institucionet që kemi me ligj. Jo të ngelen në kuadrin e ardhjes, por çdo institucion një herë në vit ose dy herë në vit, një herë për buxhetin dhe një herë për të bërë një raport vjetor, pastaj të kemi një rezolutë për të qenë dhe të mos kërkojmë llogari për kryerjen e punës.

Pyetja ime është shumë e sinqertë dhe shumë domethënëse, pasi për mua, ju jeni avokati i nëpunësve civilë.

Pranvera Strakosha – Po.

Bashkim Fino – Sot në Shqipëri ka, sipas buxhetit të shtetit, 88 mijë nëpunës, që nga Presidenti i Republikës deri te punonjësi më i thjeshtë. Hiq nga këta 88 mijë-10 mijë veta, që i kemi kaluar në buxhet për pjesën e arsimit, të shëndetësisë, që janë punësuar nga portali, pra nuk kanë të bëjnë me ju, ne themi që nga këta 88 mijë veta nuk ka më shumë nga 10 deri në 15 mijë veta, të cilët i mbulon DAP-i dhe i mbuloni ju.

Ajo që mua më bën ta ngre këtë pyetje, dhe të kërkoj që ju dhe stafi juaj të jeni të sinqertë në përgjigjet që jepni, është: a ndihet një nëpunës, me një avokat të fortë, siç është Komisioneri i Shërbimit Civil, kushdo qoftë në terren, që në qoftë se ai troket në portalin tuaj, në zyrën tuaj apo ankohet te ju, të jetë më se i sigurt se e drejta e tij, mund edhe të mos ketë të drejtë, por do të marrë sqarimin përkatës? Ky është thelbi pse ne kemi krijuar Komisionerin.

Po të ishte kështu dhe jo më kot kryetari i komisionit pyeti: “Si është bashkëpunimi me DAP-in e të tjerë?” dhe ju përgjigjeni: “Në rregull, del vendimi i qeverisë, i nxjerrin ata”...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pranvera Strakosha – Jo, për vendet e lira.

Bashkim Fino – Unë nuk jam dakord me atë që thatë ju, sepse, në fund të fundit, ministritë kanë interes t’i zënë vendet e punës. Pra, ato që kanë vende vakante, t’i japin.

Për shembull, ministritë kur vijnë, dhe ne jo pa qëllim, kur vini ju të raportoni, e bashkëngjisni me raportin që bën zëvendëskryeministri në rastin konkret që e mbulon, dhe Departamenti i Administratës Publike, kanë probleme ndërmjet tyre. Për shembull, një ministër thotë: unë kam këto vende vakante dhe ia përcjell DAP-it, ky i fundit heziton ose, më mirë të themi, e vonon në kohë shpalljen e vendeve vakante. Kjo është në disfavor edhe të vendit për të cilin ministria ose institucioni ka krijuar strukturën...

Pranvera Strakosha – Sigurisht.

Bashkim Fino – ...por edhe të atij nëpunësit, i cili ka mbaruar shkollën dhe pretendon të hyjë të konkurrojë atje. Kjo është një nga të metat kryesore. Nuk mund të thoni ju që jo gjithmonë ministria i raporton DAP-it. Jo, mor jo, ministritë...

Pranvera Strakosha – E kam nga DAP-i këtë informacion.

Bashkim Fino – ...raportojnë dhe thonë: “kemi kaq vende”, ndërkohë DAP-i...

Unë dua t’ju bëj këtë pyetje, se ju jeni avokati i nëpunësve të mi: keni vërtetuar vonesa të pajustificueshme, të paargumentuara nga Departamenti i Administratës Publike, se ka plot vende

vakante në administratën e lartë shtetërore, duke filluar nga ministritë deri tek institucione të tjera, por ajo nuk ka bërë publike, pra nuk ka shpallur për një, dy, tre ose pesë arsye dhe pse nuk duhet t'i ketë shpallur?

Sepse, së pari, në rastin konkret humbasim kohë.

Së dyti, unë që e kam bërë strukturën, që jam në një punë të caktuar, e kam bërë sepse më duhet të punoj me ata njerëz. Në qoftë se unë bëj kërkesë te DAP-i dhe ky i fundit nuk ma merr në konsideratë një muaj, dy muaj, tre muaj, vazhdon koha pafundësisht, vazhdoj të punoj me ata pesë njerëz që kam atje, me të cilët përsëri në njëfarë mënyre puna bëhet. Mos duhet rishikuar struktura e tyre? Pra, ky është thelbi i të gjithë diskutimit që ne bëjmë dhe që duam të kuptojmë këtu.

E dyta që kam, ju duhet të keni shumë broshura, shumë materiale informuese, madje edhe neve, si deputetë këtu, duhet të na kishit furnizuar me to, për të treguar se cili është roli i Komisionerit të Shërbimit Civil, sa ai është i njohur në jetën e përditshme të administratës, sepse pak më parë thatë, ndoshta me të drejtë, unë nuk e di, që keni inspektuar të gjitha bashkitë nuk e njihnin ligjin, nuk kanë njohur ende VKM-të, kryetarët e bashkive janë të fuqishëm, sepse janë zgjedhur nga populli (kjo është e vërtetë) dhe herë të dëgjojnë e herë nuk të dëgjojnë.

Unë mendoj se edhe ata kanë frikë nga ligji dhe e zbatojnë. Nuk është e vërtetë që nuk pyesin për ligjet, apo nuk janë të gatshëm, sepse detyra juaj dhe tona është që me kulturë, me mirësjellje t'u themi, se ligji thotë këtë dhe ju duhet të bëni gjë. Ua thoni 1 herë, 2 herë -3 herë dhe më pas t'i tregoni vendin çdo kryetari bashkie apo çdo drejtuesi institucioni.

Thelbi i të gjithë kësaj është që ne vijmë këtu dhe ju themi se kemi miratuar një buxhet, të cilin ju na e keni kërkuar. Ne bëjmë të pamundurën që t'ju zgjidhim problemet e buxhetit, sepse e kuptojmë rëndësinë e institucionit tuaj. Kemi miratuar numrin e punonjësve të të gjithë Shqipërisë. Ju duhet ta dini të saktë se sa i mbulon DAP-i. Kemi zbatimin e ligjit për të cilën institucioni juaj është krijuar, marrëdhënien me të tretët, duke futur edhe DAP-in.

Në fund fare është pikërisht ajo që thashë unë: a i vihet në punë nëpunësit civil një avokat të fuqishëm që të ndihet mirë në çdo drejtim dhe kur të ankohet t'i dalë se s'bën e drejta, sepse ju si institucion, do të bëni të pamundurën që atij t'i vejë e drejta në vend? Ju duhet të thoni nëse nëpunësi e ka këtë të drejtë, siç ishte rasti i atij punonjësit të Ministrisë së Bujqësisë që ka 8 muaj që e ka mbushur moshën e pensionit dhe padrejtësisht nuk e zëvendësonin.

Kjo do të thotë se jo vetëm të vejë deri në fund, por ata që e kanë shkelur ligjin të mbajnë përgjegjësi, ndërkohë që një njeri mund të jepte akoma më shumë.

Nuk e di nëse më kuptuat për thelbin e asaj që thashë.

Pranvera Strakosha – Po.

Bashkim Fino - Sepse ne po bëjmë një bashkëbisedim që edhe kur të vini ju në Kuvend apo edhe në ndonjë rast tjetër kur të vijmë, mund të mos vijmë si Komision i Ligjeve, por mund të vijë Nënkomisioni i Nëpunësve Civilë. Unë mund të mos t'ju takoj juve direkt, por mund të takoj drejtori të caktuara për të bërë punë.

Bashkë me drejtuesit tuaj mund të shkojnë edhe 2-3 deputetë nga komisioni i kontrollit në ics bashki apo në ics institucion. Kjo do të jetë më me vlerë për ty, sepse edhe ty do të të rritet autoriteti, kur një drejtor tyti do të ketë në krah edhe 2 deputetë të tjerë. Duhet ta bëjmë këtë gjë që nuk e kemi bërë deri tani. Po nuk e kërkoje ti, që merresh çdo ditë me këtë punë, nuk do ta kërkoj unë që kam më shumë punë (çdo ditë në komision, me ligje, angazhime politike, punë në zonë etj.). Nëse ti më kërkon si komision përgjegjës, atëherë ne kemi disa nënkomisione, të cilat vijnë të shikojnë, të bashkëpunojnë e të tjera me radhë.

Faleminderit për mirëkuptimin!

Pranvera Strakosha – Po.

Faleminderit!

Bashkim Fino – Edhe për lidhjen e nëpunësit me një avokat tamam.

Pranvera Strakosha – Po.

E para, që desha të them në lidhje me kryetarët e bashkive, është se ne kemi vendosur komunikim dhe unë mund të them se zbatimi i vendimeve është rreth 60%. Ne e ndjekim edhe zbatimin e vendimeve.

Pse nuk është 100%? Ne vetë kur kemi nxjerrë raportin, kemi thënë se duke konstatuar ndonjëherë që 80% e rasteve ishin marrë në kundërshtim me ligjin në një bashki. Nuk mund t'i thoshim në mënyrë të menjëhershme, që t'i heqë të gjithë nga puna brenda një dite dhe të fillojë t'i zëvendësojë, sepse ka një procedurë konkurrimi.

Atëherë, kemi kërkuar të konstatohet pavlefshmëria e akteve dhe të bëhet me faza, duke filluar paralelisht me procedurë konkurrimi. Pjesa më e madhe pas largimit nga puna janë bërë me procedurën e konkurrimit Vetëm një pjesë e vogël (rreth 30% nuk më kujtohet tamam shifra),

ka mbetur. Kjo tregon se edhe kryetarët e bashkive janë ndërgjegjësuar dhe ka filluar tashmë zbatimi vullnetar, pra nuk ka qenë nevoja për të marrë masën e gjobës.

Vjet kërkuam të rregulloheshin strukturat, sepse kemi bashki, të cilat kërkojnë edhe miratimin paraprak të strukturës me ndihmën e Komisionerit para se të miratojmë strukturën. Për shembull, kemi bashkinë e Shkodrës me të cilën kemi marrëdhënie shumë të mira dhe të gjitha problematikat që ne ngritëm në raport, ajo paraprakisht...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, i kemi realisht shumë të mira. Para një muaji na sollën strukturën dhe ne bëmë vërejtjet tona. Tani duhet ta keni miratuar. Prrenjasi, Fushë-Arrëzi, Vlora, Librazhdi janë bashkitë me të cilat kemi marrëdhënie shumë të mira.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne jemi një institucion i pavarur dhe ne e kemi mirë me të gjithë, sepse ata konstatojnë që Komisioneri kërkon të bëhet puna. Ne ua kemi bërë të qartë duke u dhënë mesazhin, se nuk kemi shkuar t'i ndëshkojmë. Ndëshkimi nuk është qëllimi i Komisionerit. Ne kemi shkuar të zbatojmë ligjin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për t'iu përgjigjur zotit Fino, për sa i përket shpalljes së vendeve vakante, pjesën e vonesave e ka ngritur DAP-i. Ne nuk kemi kohë fizike dhe mundësi me njerëz që t'i shohim të gjitha vakancat në kohë reale, sepse ne i ndjekim institucionet sipas një radhe të caktuar. Megjithatë, herë pas here ne kërkojmë nga institucionet që të na sjellin informacione, të cilat ato na i dërgojnë. Nëse ka institucion që i përgjigjet në kohë reale, unë mendoj se është Komisioneri. Kjo tregon se të gjitha institucionet që inspektohen nga Komisioneri, janë ndërgjegjësuar për rolin e Komisionerit.

Për sa u përket nëpunësve civilë, unë konstatoj se ata i drejtohen Komisionerit për çdo gjë, duke filluar që nga rekrutimet, konkurrimet, transferimet dhe vlerësimet e punës. Unë mendoj se ne e kemi krijuar besimin te nëpunësit (në fakt duhet të flasin ata vetë), por fakti që ata i drejtohen vazhdimisht komisionerit dhe jo gjykatës për çdo problematikë dhe gjejnë zgjidhje, unë mendoj se ne kemi krijuar një farë bindjeje te nëpunësit që ne jemi në mbrojtje të zbatimit të ligjit për nëpunësin civil dhe, sigurisht të nëpunësve civilë. Të paktën edhe në vendimet që kemi marrë kemi qenë në pjesën më të madhe pro nëpunësve civilë. Edhe në ato raste kur nuk u kemi dhënë të drejtë, vendimet tona kanë qenë të argumentuara me dokumentacion, me hetim administrativ.

Pra, nga letra që i shkon nëpunësit, ai kupton që Komisioneri ka hetuar çdo dokumentacion para se të arrijë në atë përfundim. Kjo ka qenë ideja jonë, t'u japim të kuptojnë që janë shqyrtuar kërkesat e tyre, duke mos u çuar një përgjigje me një letër gjysmë faqe, siç kam parë në shumë institucione të tjera, që ankesa juaj nuk u morr parasysh se nuk është e drejtë. Ne i çojmë një letër prej minimumi 4-5 faqe apo një vendim më të gjatë, ku shpjegojmë pse ai nuk ka të drejtë në kërkesën që ka bërë.

Për sa u përket materialeve informuese, ju kërkoj ndjesë, por Komisioni i ka fondet shumë të kufizuara dhe ne nuk kemi botuar asnjë material, sepse nuk kemi marrë asnjë fond nga organizmat ndërkombëtarë. Zero.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ai ka pasur shumë fonde. Nuk e di, por ne kemi pasur zero fonde për publikimet.

(Ndërhyrje pa mikrofon) ...

Në faqen tonë i kemi të gjitha.

Ulsi Manja – Për broshura e ke fjalën?

Pranvera Strakosha - Për broshura, pra.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Alket Hyseni – Besniku ka aplikuar për komisioner.

Pranvera Strakosha – Në faqen tonë zyrtare në internet ne kemi çdo shkresë, vendim, urdhër apo çdo gjë tjetër. Veç udhëzimeve që kemi nxjerrë tani do të bëjmë edhe manualët. Për institutet e veçanta të ligjit do të nxjerrim edhe aplikime tip për t'i pasur institucionet më kollaj.

Fillimisht kemi pasur një projekt shumë ambicioz, por që nuk kemi gjetur akoma fonde, për të ndërtuar sistemi e monitorimit online të institucioneve të administratës që punësojnë nëpunës civilë. Do të thotë që çdo veprim që ata do të bënin në zbatim të ligjit të vinte në kohë reale te serveri i komisionerit dhe inspektorët tanë ta ndiqnin atë në kohë reale.

Patëm një eksperiencë në vitin 2017, kur monitoruam sjelljen e nëpunësve civilë gjatë fushatës zgjedhore, ku kishim atashuar inspektorë në institucione të caktuara dhe komunikonim me ta gjatë gjithë ditës.

Bashkim Fino – Këtë e zgjidhi Rama. Vuri ministra nga PD-ja. Këtë herë administrata ishte korrekte.

Pranvera Strakosha – Ju mendoni se u zgjidh ngaqë u vunë ministra nga PD-ja?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bashkim Fino – Unë kam qenë dhe jam deputet në qarkun e Fierit. Në Lushnjë, qytet që unë përfaqësoj, nuk më dilte asnjë njeri në fushatë para orës 16:00, duke përfshirë edhe ata që ishin me taserë të partisë sime.. Në këtë rast ju ka ndihmuar Kryeministri.

Pranvera Strakosha – Nuk më ka ndihmuar Kryeministri, por unë atë.

Bashkim Fino - Sa persona ke në administratë? Me 15 apo 20 veta që ke në administratë i kontrollon dot 15 mijë vetë në 1 muaj që dalin apo jo në fushatë?

Pranvera Strakosha – Në muajin prill ne kemi kërkuar të ngrihen grupe pune, kurse VKM-ja për ngritjen e taskforcës, ku unë isha pjesë, ka dalë në fund të majit. U kërkuam institucioneve të ngrinin grupe pune, u dërguam një rregullore model të disiplinës dhe i kërkuam që të bëhej apeli 3 herë në ditë, i cili i vinte komisionerit çdo ditë në orën 16:00. Ne i kemi monitoruar çdo ditë institucionet. Inspektorët tanë punonin jashtë orarit të punës dhe na vinin në dijeni që sot nuk ka qenë në punë iksi dhe ipsiloni. Më pas ne i dërgonim *e-mail* komisionit ku e pyesnim pse nuk ka qenë iksi apo ipsiloni në punë. I kemi kërkuar në rregullore që edhe nëse dilte për inspektim, duhet të jetë me autorizim të posaçëm gjatë gjithë kohës. Në takimin e parë që bëra me zëvendëskryeministren në fund të majit dhe i thashë që kemi filluar këtë gjë, e mori si gjetje dhe u bë VKM-ja për taskforcën. Të paktën këtë gjë mos na e mohoni. Ne ishim 1 muaj përpara.

Bashkim Fino – Nuk ta mohoj, por thashë që ju ka ndihmuar edhe Kryeministri.

Pranvera Strakosha – Jo, fare.

Bashkim Fino – Nuk mund ta thuash këtë gjë.

Alket Hyseni – Më vjen keq që komisionerja nuk është ndihmuar nga Kryeministri.

Komisionere, unë po flas në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Ligjeve, por edhe në cilësinë e kryetarit të nënkomisionit për Administratën Publike.

Ne kemi kënaqësi që jemi këtu sot, e cila buron nga fakti që kemi një institucion varësie, por edhe nga rëndësia që ne i japim reformës në administratën publike. Sikurse ju e dini, ky është një nga prioritetet për anëtarësim në të cilin është fokusuar qeveria dhe parlamenti. Besoj se ka përmirësime të dukshme sikurse edhe ju i konstatuat. Megjithatë, ne mendojmë që situata nuk është kaq rozë. Fakti që ju keni marrëdhënie kaq dashurore, qoftë me DAP-in, qoftë me institucionet që kontrollojnë, nuk na duket gjë e mirë, sepse duke e ditur që situata në terren nuk është kaq rozë marrëdhëniet nuk duhet të ishte kaq e ngrohtë, por pak më antagoniste. Megjithatë, do të kemi kohë të flasim më në detaje kur ju të paraqisni raportin.

Unë kam shqetësim disa procese në të cilat involvohet komisioneri.

Së pari, është procesi i rekrutimeve. Për ne është e rëndësishme jo vetëm ana sasiore në sensin e plotësimit të të gjitha vendeve vakante për ta bërë administratën eficiente dhe atë mekanizëm të madh të jetë i kompletuar që të vazhdojë ritmin e reformave, por edhe ana cilësore. Sa aktivë keni qenë ju në kontrollin e kriterëve të rekrutimit të administratës dhe anën formale të procedurave, pasi te komisioneri ka edhe procese ankimuese me aq sa dijeni unë kam?

Këtu del në pah antagonizmi midis jush dhe DAP-it, pavarësisht se DAP-i është një institucion, që performon komplet ndryshe nga çfarë performonte 5 vjet më parë. Raportet e Bashkimit Europian thonë se ka një përmirësim të dukshëm. Besoj se ju e keni konstatuar, por, ashtu sikurse u shpreha se ka rezerva, edhe ato raporte kanë akoma rezerva, të cilat nuk i dëgjova në prezantimin tuaj.

Për ne është i rëndësishëm procesi i vlerësimeve periodike. Unë të garantoj që shumica e administratës e bën formal. Unë që flas vij nga administrata; kam qenë drejtues, specialist, përgjegjës sektori, drejtues i lartë, dhe kam parë se si komportohet administrata me procesin e vlerësimit. Është një proces që akoma nuk ka marrë rëndësinë e duhur edhe pse është shumë i rëndësishëm. Nga ai rrjedh elementi i performancës dhe vijimësia e reformave, por nga ana tjetër të jetë edhe një mundësi, që është opsioni i tretë: trajnimi. Pra, nëse një nëpunës nuk ka cilësitë e duhura, performancën e duhur, me legjislacionin tonë dhe institucionet tona, siç është ASPA, atij i jepet mundësia të kalojë në një moment tjetër, në trajnim. Nuk e di nëse ju e ndiqni apo jo fazën e tretë, procesin e trajnimit të nëpunësve të administratës.

U shpreha për këto, sepse sfidat janë të mëdha. Duhet të jemi koshientë që administrata jonë përballlet me sfida, për të cilat ndoshta nuk është e përgatitur 100%. Janë dallgë më të mëdha dhe kërkohet anije më e madhe për t'i përballuar. Kjo do të thotë se në duhet të jemi të përgatitur dhe me një administratë të kualifikuar.

Ju përmendët disa shqetësime këtu. Kolegët e mi ju ngritën disa shqetësime, por unë mund t'ju them se ka një shqetësim, që qëndron në mënyrë alarmante. U ngrit problemi i pensionistëve në administratë. Ju garantoj që numri i pensionistëve në administratë është shumë i lartë, në shkelje flagrante të ligjit. Mund t'ju jap një shembull, fatkeqësisht, në një nga bashkitë që unë mbuloj, që është edhe e forcës sonë politike. Aty ka 8 pensionistë, që janë drejtues të lartë. Ti nuk mund të më thuash se ke marrëdhënie të mira edhe me atë, se po e the këtë...

Pranvera Strakosha – Me cilën bashki?

Alket Hyseni – 8 drejtues. Është e patolerueshme!

Unë e kam ngritur shqetësimin, por nuk kam gjetur rrugën e zgjidhjes. Të shohim se çfarë do të bëni ju. Janë 8 drejtues. Unë jap llogari për ato që them. Janë 8 persona në nivel drejtimi. Kjo gjendje është edhe në disa bashki të tjera, me aq sa kam informacion, por numri është më pak, 3, 4... Abuzohet kur thuhet se nuk kemi njerëz. Ka njerëz sa të duash. Ka të rinj të kualifikuar, brenda dhe jashtë vendit, të cilëve nuk u jepet mundësia të jenë pjesë e administratës, sepse ne u mbyllim dyert. Besoj se roli juaj nuk duhet të jetë të mbrojtë vetëm ata që largohen pa të drejtë nga puna, por edhe për performancën, kriteret dhe procedurat e institucioneve. Unë e kuptoj, me stafin që keni është e pamundur të mbuloni të gjitha institucionet në të njëjtën kohë, sepse numri i tyre është i madh, por kjo gjë duhet goditur dhe duhet dhënë një shembull.

Penalitetet, që i ka parashikuar ligji, janë të rëndësishme. Kur ju shkoni te një institucion dhe e penalizoni atë, se nuk ka zbatuar ligjin, e marrin vesh të gjitha institucionet e tjera, por nëse ne shkojmë dhe përkëdhelim një institucion, ata të tjerët do të thonë: “S’ka gjë, se e gjejmë gjuhën” dhe kështu kalojmë te marrëdhëniet e mira, që mund të zgjidhin situata momentale, jo vijimësinë.

Është i drejtë shqetësimi se nuk deklarohen vendet e lira. Edhe nga DAP-i ka ardhur ky shqetësim kur kemi diskutuar.

Pranvera Strakosha – Nga DAP-i e kisha.

Alket Hyseni - Është e vërtetë që ka institucione, të cilat i mbajnë me rezervë vendet për periudha të caktuara. Nuk mund të paragjykoj qëllimet, por le të marrim qëllimin më të mirë që shprehin ndonjëherë drejtuesit: “Po i mbajmë, se nuk ka njerëz dhe kur të na paraqitet ndonjë...”. Kjo është akoma më...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pikërisht.

Nga ana tjetër, ju nuk na ngritët shqetësimin e vonësve në shpallje për institucionet që i dërgojnë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e ngritët shqetësimin e institucioneve që i kanë çuar dhe vonohen në shpallje, edhe për shkak të ngarkesës së DAP-it. Hajdeni të flasim, se ne këtu jemi. Nëse ka nevojë të bëjmë ndonjë përmirësim ligji, nëse ka nevojë t’i kërkojmë qeverisë ndonjë shtim strukture, këto gjëra diskutohen këtu. Prandaj kemi ardhur këtu, për të folur në vendin ku duhet, në vendin ku mendojmë se marrin zgjidhje problemet dhe duke hequr petkun e burokracisë, kur ju vini dhe raportoni në komision. Ne kemi ardhur te ju për t’ju dëgjuar konkretisht.

A ka nevojë për përmirësime ligjore në kuadrin e ekzekutimit të vendimeve? Mendoj se nuk është kjo zgjidhja.

Ju ngritët shqetësimin për përmbaruesit privatë. Aktualisht, jemi duke diskutuar ligjin për përmbaruesit privatë. Ne nuk mund ta kushtëzojmë nëpunësin civil me zgjedhjen e përmbaruesit shtetëror, sepse kemi futur në institucione përmbarues privatë pikërisht për t'i dhënë liri zgjedhjeje cilitdo subjekti që kërkon të ekzekutojë të drejtën. Kjo ka qenë ideja dhe tani nuk mund t'i themi: “Shko patjetër te përmbaruesit shtetërorë”. Të garantoj që më pak do të gjendet e drejta nga nëpunësi. Pra, në qoftë se përmbaruesi privat mund të kapërcejë tagrin, është gjykata... Ju e dini shumë mirë. Orientohen institucionet që t'i kërkojnë gjykatës kundërshtimin e veprimeve përmbarimore. Këto janë tagrat që përcakton Kodi i Procedurës Civile. Ne nuk mund të bëjmë akrobaci, se 1 apo 10 nga përmbaruesit privatë shkelin ligjin. Nëse ata e shkelin ligjin, kontrolli bëhet nga gjykata dhe jo vetëm. Është edhe Ministria e Drejtësisë që ka kompetenca kontrolli, Drejtoria e Profesioneve të Lira. Është edhe Dhoma e Përmbaruesve Privatë, që ka...

Bashkim Fino – Shkurtimisht, që të shohim edhe ambientet! Nuk kemi ardhur këtu të bëjmë mbledhje...

Alket Hyseni – Një herë na u dha mundësia që nënkomisioni....

Bashkim Fino – Mbledhje bëjmë edhe atje ne. Të shohim pak se ku punojnë dhe si punojnë. Ti je kryetari dhe do të flasësh prapë gjatë...

Alket Hyseni – Mendoj se duhet të jemi pak më të kujdesshëm. Unë e njoh eksperiencën tuaj. E di shumë mirë që keni një eksperiencë shumë të mirë, edhe në fushën e legjislacionit, edhe në gjyqësor, por mendoj se ndonjëherë zgjedhjet radikale nuk na çojnë te zgjidhjet e duhura. Duhet të kultivojmë kulturën e institucioneve, që të godasin vendimet e padrejta të përmbaruesve në gjykatë.

Megjithatë, ju garantoj se do të keni mbështetjen absolute të nënkomisionit, sepse së bashku kemi të njëjtin qëllim.

Do të preferoja që në raportimet e tjera më shumë të kishte antagonizëm të komisionerit sesa marrëdhënie të ngrohta, sepse...

Pranvera Strakosha - Varet si e kupton këtë.

Alket Hyseni - E mora të mirëqenë, sepse...

Nuk thashë që ju të shkoni të ziheni nëpër institucione.

Pranvera Strakosha – Absolutisht, por varet se çfarë quani ju marrëdhënie të ngrohta. Unë jam e sjellshme, por vendimin e çoj ashtu siç duhet.

Alket Hyseni - Do të doja që ju të ishit refraktare, të keni një rol agresiv, sepse ka vend për të qenë agresivë në administratën tonë.

Faleminderit!

Pranvera Strakosha – T’ju kthej një përgjigje?

Për sa u përket marrëdhënieve të ngrohta dhe të mira, në qoftë se unë kam nxjerrë një vendim që mbron institucionin, kjo është histori tjetër. Në qoftë se do të shikoni vendimet e inspektimit, ato janë shumë të detajuara. Nuk kemi falur asnjë lloj institucioni, duke filluar nga DAP-i e deri tek të tjerët.

I kemi thënë institucionit: “Ke gabuar. Të lëmë 30 ditë kohë për ta rregulluar”. Fakti që këtë e them pa ndonjë ngritje zëri, do të thotë se janë në marrëdhënie të mira. Pra, ju duhet të shikoni vendimmarrjen e komisionerit. Nuk kemi mbrojtur asnjë institucion dhe për këtë ju siguroj. Mjafton të hapni vendimet.

Për sa i përket pjesës së rekrutimeve, që janë sasiore, duhet të jenë cilësore. Në fakt...

Alket Hyseni – E di pse kundërshtoj unë?

Ju përmendet një bashki që keni marrëdhënie shumë të mira. Mund t’ju jap një shembull? Çfarë keni bërë ju ditën e protestave, kur Bashkia e Shkodrës boshatisi sportelet? Meqë ju keni marrëdhënie të mira, komisioneve, me gjithë respektin që kam ...

Pranvera Strakosha – Mua më vjen keq!

Alket Hyseni – Në fushatë elektorale ...

Pranvera Strakosha – Ju lutem, zoti Hyseni!

Unë ...

Alket Hyseni – E keni në kompetencë për të kontrolluar.

Pranvera Strakosha - Jo, nuk e kam kompetencë.

Alket Hyseni – Pse e kishit në fushatë?

Pranvera Strakosha – Në fushatë mora vendimin se ka pengesë ligjore.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, nuk isha në taksforcë.

Përderisa është ligji ...

Alket Hyseni – Vetë thatë se ishit anëtar i taksforcës, nxorët një urdhër dhe e keni kontrolluar, apo jo? Unë u nisa nga kjo.

Pranvera Strakosha – Të mos dalim në gjëra konkrete. Nëse unë do të kisha inspektorët e mi atje, është histori tjetër. Unë nuk i kam pasur inspektorët atje, sepse nëse do të ishin në inspektimin e përgjithshëm, do ta kishin konstatuar edhe këtë gjë. Inspektorët e mi nuk ishin në bashki. Doli një emision ku u tha që nuk janë. Inspektorët e mi nuk ishin atje, në mënyrë që unë të filloja.

Më vjen keq që dilni në diçka kaq elementare.

Alket Hyseni – Unë dal, sepse ajo është periodike. Ka protesta çdo javë dhe ju mund ta verifikoni.

Pranvera Strakosha – Unë kam vetëm 12 inspektorë, me të cilët duhet të bëj të gjitha punët. A munden 12 inspektorë në Shqipëri, që i kam të gjithë rrugëve... Muajin e kaluar i kam pasur të gjithë nëpër bashki.

Alket Hyseni – Flasim teorikisht.

Nëse ju arrini ta konstatoni, çfarë kompetencash keni? Të iluminohe mi nga pikëpamja e kompetencave.

Pranvera Strakosha – Do t'u kërkoj të fillojnë procedimet disiplinore, siç kam kërkuar në rastet e zgjedhjeve në vitin 2017, nëse kanë shkelur një nga detyrimet. Ne kemi dalë edhe me një udhëzim, ku kemi shpjeguar se si mund të marrë pjesë nëpunësi civil në fushatë zgjedhore. Në vitin 2017 kemi interpretuar nenin 37 dhe kemi thënë se në orarin zyrtar nuk diskutohet që nuk mund të dalë. Pas orës 16:00 mund të marrë pjesë, sepse çdo nëpunës civil mund të aderojë në një parti, apo mund të aspirojë, por nuk mund të dalë e të flasë, nuk mund të bëjë veprime protagoniste, që do të thotë se do të rrijë në fushë dhe do të dëgjojë alternativa të ndryshme politike.

Kalojmë në pjesën tjetër. Po ju them se Komisioneri nuk mundet, sepse ka vetëm 12 inspektorë dhe 4 juristë të Drejtorisë Juridike, të cilët edhe ata i çon me urdhër që të bëjnë inspektime për shkak të numrit të kufizuar. E thashë edhe një herë, që unë kam marrëdhënie shumë të mira, nuk kam arsye t'i prish, por jam në nivel kontrolli. Duke qenë se kam një eksperiencë nga gjyqësori, gjyqtari duhet të jetë shumë i qetë, shumë i pavarur, shumë i ftohtë në vendimmarrje, nuk mund të dalë në sallë e të bëj debat, por do të shprehet me vendim. Komisioneri shprehet me vendim. Nëse konstaton se nuk zbatohen vendimet, fillon faza e gjobitjes. Kjo është pjesa që unë them.

Për sa u përket rekrutimeve, Komisioneri nuk ka tagër të shikojë vlerësimin e komisionit, sepse është diskrecion i komisionit. ngrihet një komision vlerësimi në rastet e rekrutimit dhe ky është një handicap, për të cilin unë nuk mund të them nëse u vlerësua mirë apo keq. Unë shikoj procedurën dhe nëse është konform ligjit, nuk është absolutisht e pavlefshme. Nëse ne konstatojmë se procedura është në kundërshtim me ligjin, kam pezulluar veprime të DAP-it, kur i kam konstatuar në kundërshtim me ligjin, si për shembull, sekretar të përgjithshëm të ministrive, që merrnin tezën dhe e nxirrnin e të tjera. Unë shkoj dhe i shikoj me inspektorët. Këto gjëra nuk bëhen publike. Janë në faqen tona zyrtare, por unë nuk mund të dal në televizor dhe të them se Komisioneri ka bërë këtë gjë, sepse nuk më pëlqen kjo pjesë. E thashë edhe një herë, se për shkak të një eksperience në gjyqësor, kam natyrën time që e shpreh me vendim, e rregulloj situatën dhe raportoј në komision në Kuvend. Këto janë detyrimet e mia ligjore.

Për sa u përket vlerësimeve formale, e kam ngritur këtë çështje 2 vjet rresht në raportin para Kuvendit që duhen ndryshime ligjore. Vlerësimi me 4 nivele vlerësimi është i pamjaftueshëm dhe bëhet formal. Në çdo raport inspektimi ne kemi një tabelë ku thuhet sa janë vlerësuar “shumë mirë”, sa janë vlerësuar “mirë” dhe sa janë vlerësuar “jokënaqshëm”, sepse nga kjo vjen edhe subjektivizmi. Kemi thënë se nuk ka antagonizëm, nuk ka konkurrencë të mirë. Nëpunësi e di, do të vlerësohet me 1 ose 2 dhe do të rrijë atje. Ne kemi thënë që vlerësimi të hapet dhe të bëhet me 10 nivele, në mënyrë që të ketë edhe një farë motivimi për atë që do të fitojë. Nga 4-a do të shkojë në 3-shi dhe nga 3-shi do të shkojë te 2-shi. E kemi ngritur në raport. Ju e thatë tani, por unë kam 2 vjet që e them.

Për sa u përket trajnimeve dhe nëpunësve në periudhë prove, nuk kemi mundur ende ta kontrollojmë dhe ta vlerësojmë për shkak të ngarkesës së madhe dhe njerëzve të pamjaftueshëm. Jemi mjaftuar me një shkëmbim eksperience, por nuk mund të them se sa cilësore janë trajnimet e ASPA-s. Nuk kam mundur, sepse nuk kam kohë fizike dhe kam vlerësuar më shumë pjesën e parë, që të jemi më shumë operativë në institucione, në zbatimin e ligjit dhe pjesën tjetër e kemi ndjekur në nivel të dytë.

Këto janë përgjigjet e pyetjeve që m’u bënë. Saranda nuk paska sjellë vlerësim.

Alket Hyseni – Unë thashë se atë di saktë.

Pranvera Strakosha – Janë 14 institucione që nuk kanë sjellë informacion për pensionet. Të tjerët i kanë sjellë të gjithë personat që mbushin moshën për pension dhe kjo është me iniciativën e Komisionerit. Pra, kërkimi i pozicioneve ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, unë jam në ndjekje të kësaj pune. Saranda nuk m'i ka sjellë.

Ulsi Manja – Ka pyetje të tjera?

Klotilda Bushka – Në dëgjuesën e vjetshme me institucionin tuaj kemi bërë një pyetje për verifikimin e rasateve me bashkitë dhe institucionet qendrore të proceseve gjyqësore, që janë ...

Pranvera Strakosha – Ta them shkurt.

Ne kemi një produkt, e kemi thënë në komision.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E kemi thënë edhe në komision, kemi nxjerrë edhe objektin. Pra, pse janë fituar ato vendime gjyqësore, sa janë ekzekutuar, sa nuk janë ekzekutuar. 200 e ca ka administrata shtetërore dhe 90 e ca administrata ... Të gjitha tabelat e raportit i kemi këtu, për të krijuar një ide. Do të fillojmë fazën e dytë, do të merremi me ekzekutimin. Janë 311 vendime gjyqësore, por këtu nuk janë përfshirë institucionet e varësisë me përjashtim të doganave dhe tatimeve. Këto të dyja, duke qenë se kanë problematikë më të madhe, nuk i kemi përfshirë. Në fazën e parë kemi këshilla qarku, institucione të pavarura, bashkitë, ministrinë, doganat dhe tatimet. Pjesën tjetër besoj se do ta fillojmë 6-mujorin e dytë. Do të fillojë fushata zgjedhore, ku besoj se do të bëjmë monitorim. Fondet nuk i shtuan, edhe pse kërkuam shtesë të shërbimeve.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kërkuam fonde.

Strukturë kemi kërkuar çdo vit dhe nuk është miratuar. Unë jam mësuar që nuk miratohet dhe e lë me aq muhabetin.

Alket Hyseni – Kërkoje edhe një herë këtë vit.

Pranvera Strakosha – Çdo vit e kam kërkuar.

Klotilda Bushka – Keni të dhëna sa paguajmë ne për një vend pune sot?

Pranvera Strakosha – Nuk kemi arritur, sepse edhe këto vendime që kemi lexuar, pse janë hequr nga puna dhe pse i ka kthyer gjykata, kryesisht ishin për shkak ristrukturimi. Pra, janë shkurtuar vendet e punës dhe në pjesën më të madhe gjykata ka dhënë vetëm kompensimin, që paguhet me vjetërsi në punë e të tjera. Por kemi edhe rikthime në punë. Megjithatë, do të fillojmë seanca dëgjimore, kemi bërë sallën lart, të cilën do ta shikoni. Do të instalojmë edhe foninë tani, sepse ne duam që të gjitha trajnimet t'i bëjmë në sallën tonë edhe për faktin që kemi një godinë të re dhe i kemi të gjitha kushtet. Pra, sapo të fillojmë çdo ministri...

Bashkim Fino – Ju si institucione keni të njëjtën sallë apo vetëm ju?

Pranvera Strakosha – Jo vetëm ne, ndërsa Besniku ka sallë tjetër.

Adnor Shameti –Të dy mund të përdorin një sallë dhe paratë i përdorin për ndonjë gjë tjetër.

(Diskutime pa mikrofon)

Ulsi Manja – Unë dua të bëj shkurtimisht mbylljen e takimit. Në fakt, jam plotësisht dakord me mendimin e kolegut Hyseni, që administrata e shërbimit civil nuk është ajo që ka qenë para 5-6 vjetësh dhe sigurisht nuk është ajo që ne kemi pritur pas 6 vjetësh të qeverisë.

Zoti Fino u shpreh se ju jeni avokatja e 15 mijë nëpunësve të shërbimit civil nga 88 mijë buxhetorë që ka shteti shqiptar qoftë në nivelin qendror, qoftë në nivelin vendor. Unë jam shprehur edhe më parë, kur ju keni raportuar vitet e mëparshme në Komisionin e Ligjeve, për seriozitetin e punës që ka institucioni që ju përfaqësoni, një institucion, i cili vit pas viti ka ardhur duke e ngritur cilësinë e punës, por jo gjithçka është me ngjyra, ashtu siç u shprehët në raportimin tuaj.

Mua më kanë lindur shumë pyetje për të cilat do të marr përgjigjet e duhura kur ju të vini të raportoni në Komisionin e Ligjeve, këtë gjë do të kërkoja edhe nga kolegët, që problemet që u raportuan këtu t’i kemi në konsideratë kur të raportojë Departamenti i Administratës Publike, si dhe zëvendëskryeministri së bashku me drejtoreshën e DAP-it.

Unë kam kërkuar që edhe raporti i Kontrollit të Lartë të Shtetit të filtrohet përpara se ju të vini të raportoni në komision, për ta zhveshur raportimin e të gjitha këtyre institucioneve që monitorojnë administratën publike nga ato ngjyrat që secili institucion i jep punës së vet, sepse administrata civile ka probleme. Cilat janë këto probleme? Këtë gjë unë dua të di kur ju të vini në komision dhe të na raportoni anën e errët të marrëdhënieve që ju keni me administratën publike, por edhe me institucionet që ju keni monitoruar.

Për shembull, ju thoni që në fazën e rekrutimit ju nuk kontrolloni vendimmarrjen e komisionit, kjo është normale se nuk keni sesi ta kontrolloni, por keni raste të pezullimit të procedurave të Departamentit të Administratës Publike. Unë dua të di, ta keni në konsideratë këtë gjë kur të vini, në sa raste falë avokatisë suaj si Komision i Shërbimit Civil është rivendosur e drejta e një punonjësi apo i një kandidati që ka konkurruar për një pozicion pune në raport me fituesit e shpallur në momentin e parë? Nuk është e vërtetë që për 1008 vende në shërbimin civil vonesat për plotësimin e vendeve vijnë për shkak se nuk ka kandidatë cilësor për t’i fituar këto pozicione. Këtë jam duke e thënë në shtëpinë e avokatit të shërbimit civil. Shqipëria ka shumë

djem dhe vajza që jo vetëm shkëlqejnë në fushat ku janë diplomuar brenda dhe jashtë Shqipërisë, por ju duhet të jeni në krahë të tyre për ta çelur ashtu siç duhet këtë derë që ata të bëhen pjesë e shërbimit civil.

Pse pikërisht tani u gjetën 400 ekselentë, duke u plotësuar vendet në shërbimin civil? Ku ishin deri dje këta? Vjet kanë qenë 1098 vende sipas VKM-së së shërbimit civil, prandaj dua të di se sa prej tyre u plotësuan për vitin që shkoi? Kjo duhet të jetë pjesë e raportit tuaj.

Pranvera Strakosha - Kjo është pjesë e raportit.

Ulsi Manja – Sa u plotësuan dhe sa jo?

Pse pikërisht tani, 2 javë pas lancimit të projektit të qeverisë dhe të Kryeministrit për plotësimin e vendeve vakante me studentët e ekselencës numri ka vajtur në 400 e ca? Ku ishin deri dje këta njerëz? Unë dua që në raportimin që ju do të bëni të dalë pjesa e marrëdhënieve që ju keni me shërbimin civil. Po ashtu edhe për rastet e pensionit dua të evidentohen të gjitha. Si mundet të marrim ne jashtë dyerve të shërbimit civil njerëz të përgatitur, ndërkohë që në disa institucione mbahen punonjës që kanë mbushur moshën e pensionit? Ligji e lejon këtë, por në profesione të tilla siç janë mjekët...

(Diskutime pa mikrofon)

...raste të veçanta dhe kur nuk ka potencial për t'i zëvendësuar, por jo të rri dy vjet në shërbimin civil...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër, edhe këto i duam ne. Këtë herë ndryshon mënyra e raportimit, jo vetëm si kontroll parlamentar, por edhe në raportet tona si parlament me ekzekutivin, ia kemi kërkuar vazhdimisht edhe qeverisë dhe nga ana e saj kemi dritën e plotë jeshile për të vënë para përgjegjësisë këdo drejtues institucioni të pavarur ose të krijuar me ligj, që nuk bën detyrën si duhet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ia kemi vënë në dukje qeverisë. I kemi thënë se çfarë bën DAP-i, ka këto mangësi 1, 2, 3, 4 dhe do të mbajmë qëndrim.

Tjetra, për rastet e marrjes së rrogës, cili është dëmi që i bëhet buxhetit të shtetit nga marrja e rrogës nga nëpunësit civilë, që edhe pse u janë ofruar pozicione në shërbimin civil, ata vazhdojnë të punojnë jashtë tij dhe ndërkohë marrin rrogën e plotë, siç ishte një rast për një punonjëse që ka marrë mbi 100 milion lekë të vjetër, edhe pse i është ofruar pozicion pune në

shërbimin civil. Na i evidentoni këto raste, sepse, nëse është nevoja për ta ndryshuar ligjin, do ta bëjmë. Ne nuk mund të pranojmë tri administrata.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka rëndësi! Nuk është çështje që mund ta diskutojmë tani. Nëse është nevoja për të ndryshuar ligjin, do ta ndryshojmë ligjin, por ne nuk mund të paguajmë 4 administrata paralele në shërbimin civil me taksat tona.

E fundit, që dua ta përmbyll, sepse ka shumë problematika, përpara se të vini të raportoni, fokusin e raportimit, se çfarë duam ne të raportoni në komision, do t'ju sjellim me shkrim sapo të kthehemi në zyrë. Raportet për kontrollet që keni ushtruar në secilën bashki dhe i keni sjellë në formën e raporteve periodike për shkeljen e ligjit për Shërbimin Civil në disa bashki të Republikës i kam marrë, edhe nënkomisioni përkatës i ka marrë për t'i trajtuar ato raporte, por do të duhet të ndryshojmë shumë gjëra në mënyrën e raportimit, jo atë raportimin rutinë. Vihet në komision, raportohet, del një rezolutë dhe të gjitha palët bëjmë sikur punojmë, jo!

Sa për monitorimin, është e vërtetë që edhe sikur të lini nga një inspektor te dera e bashkive të djathta ditën që ka protestë, të jeni e bindur që ata të gjithë do të shkojnë në protestë dhe kjo nuk është absolutisht përgjegjësia juaj, por që të hartoni raporte përkatëse, qoftë edhe për këtë problematikë për pjesën e shërbimit civil, sepse në bashki, jo të gjithë punonjësit janë në sferën e ligjit të shërbimit Civil, por ju duhet t'i bëni pjesë të raporteve në ditët në vazhdim, apo raporteve periodike, sepse, në fund të ditës, brenda orarit 8.00 - 16.00, çdo nëpunës publik përgjigjet për shërbimet që ofron në sportelet ndaj qytetarëve. Ligji mbron qytetarin dhe jo nëpunësin. Këto do të duhet t'i bëni, bashki të djathta apo të majta, që edhe kur kemi aktivitete politike brenda orarit zyrtar, po të njëjtin monitorim dhe mbikëqyrje do të duhet të bëni edhe në bashkitë që drejtojmë. Këto do të duhet t'i keni në fokusin e punës suaj, por, gjithsesi, le të shërbejë kjo vizitë e parë jona në këtë institucion si një fazë e re edhe e punës sonë si Komision i Ligjeve, por edhe i nënkomisionit përkatës, për të ushtruar si duhet kontrollin parlamentar, pse jo, duke u bashkuar edhe me sugjerimin e kolegut Fino, si parlamentar i vjetër, që aty ku ne e çmojmë të nevojshme, mund të vijmë edhe në cilësinë e nënkomisionit të administratës të bëjmë kqyrjen në vend se si funksionon Shërbimi Civil.

Këtu dua ta mbyll.

Dua t'ju falënderoj të gjithëve si staf për mikpritjen, pse jo të bëjmë edhe një vizitë në ambientet e punës që keni, që zoti Fino herën tjetër kur të vini për të miratuar buxhetin, t'i mbajë shënim, që ta lëshojë pak dorën.

Mirupafshim!